

RELACION TEKNIK PER OBJEKTIN "RIKONKUNSTRUKSION I KANALIT KRYESOR (KOLEKTORI) PERROI I LINGAJCES NGA RRUGA E FUSHES DERI TEK LAGJJA E HALLIDRIT" FSHATI RRAJCE, NJESIA ADMINISTRATIVE RRAJCE, BASHKIA PRRENJAS.

Renia e shirave te jashtezakonshme ka krijuar situata emergjente ne territorin e Bashkise Prrenjas per shkak te prurjeve te medha te inerteve ne kolektorin e Lingajces eshte rritur teper niveli i ketij kolektori duke u bere rrezik per permbytje te tokave bujqesore perreth. Kjo situata eshte edhe per faktin se ne kete kolektor nuk eshte nderhyre prej vitesh me investime dhe kjo e ben edhe me te domosdoshem nderhyrjen ne kete veper me qellim rikonstrukcionin e segmentit nga rruga kryesore deri tek shtepite e Hallidrit ku perroi ka nje kthese e cila shkakton gerryerje te tokes bujqesore.

Ky kolektor mbledh ujrat e gjitha pellgut ujembledhes te Rrajces e te Sutanit, e per rrjedhoje ne kohe piku prurjet e ujit jane shume te medha e sjellin edhe sasi te medha inertesh. Per te minimizuar demin eshte e domosdoshme nderhyrja me investime duke kryer rikonstrukcionin e ketij kanali per nje segment qe eshte me i rrezikuar e konkretisht segmenti nga rruga kryesore deri tek shtepite e Hallidrit.

Ne kete segment do te kryhen punime te karakterit sistemimi i argjinaturave, thellimi i shtratit, riparimi i shpateve te kolektorit etj. Ne te gjitha gjetesine materiali i germuar do te transportohet.

Pas kryerjes se punimeve pergatitore gjitha kolektori do te betonohet ne gjatesine 485 ml, ku do te vendoset edhe hekur Φ -10 ne forme rrjete dhe trashesia e betonit mbi 15 cm ndersa marka 16/20

Gjeresia e kolektorit ne baze do te jete 2.5 ml dhe lartesia mbi 1.5 ml duke i dhene faqeve pjerresi natyrale. Ne kete menyre ky kolektor do te percjelle nje sasi me te madhe uji dhe ne menyre te sigurt pa shkaktuar gerryerje per gjate trupit te vet.

Me perfundimin e ketij investimi do te perfitojne fshatrat Rrajce, Sutaj, Urake dhe Prrenjas-fshat ku hiqet nga harta e rrezikut nje siperfaqe prej mbi 100 ha toke bujqesore dhe nga ky investim perfitojne nje numer popullsie mbi 7000 banore. Realizimi i investimit nuk ka probleme te karakterit te pronesise pasi e gjitha prona eshte shteterore nen monitorimin e sektorit te Ujitjes dhe Kullimit prane Drejtorise se Bujqesise dhe Konsumatorit ne Bashkine Prrenjas.